



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT  
REGULATORNA TORIŠTA ZA USLUGE VODE  
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



Instituti Kombëtar i  
Shëndetësisë Publike  
të Kosovës

Në përputhje me nenin 6 paragrafi 2.6, lidhur me nenin 21 paragrafin 2.1.1, të Ligjit Nr-03/L-149 për Shërbimet Civil të Republikës së Kosovës, "Gazeta zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-72/2010", Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit dhe Instituti Kombëtar për Shëndetin Publik në Kosovë, bëjnë:

 Nr. Protokollit: 712 Data: 09/12/2022	<b>MËREVEESHJE E BASHKËPUNIMIT</b>  <b>MIDIS:</b>	 Nr. Protokollit: 06 Data: 19.12.2022
--	---	---

**AUTORITETIT RREGULLATOR PËR SHËRBIME TË UJIT (ARRU)**

**DHE**

**INSTITUTIT KOMBËTAR PËR SHËNDETËSI PUBLIKE NË KOSOVË (IKSHPK)**

#### Identifikimi i palëve në këtë Marrëveshje të Bashkëpunimit

Palët e identifikuara në këtë Marrëveshje të Bashkëpunimit janë: **Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit** (në tekstin në vijim i referohet si **ARRU**) dhe **Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë** (në tekstin në vijim i referohet si **IKSHPK**).

- Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU)** si autoritet i pavarur, është përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe të furnizuesve të ujit me shumicë. Roli i ARRU është që të sigurojë ofrimin e shërbimeve cilësore, eficiente, dhe të sigurta në baza jo-diskriminuese për tërë konsumatorët në Kosovë, duke pasur parasysh mbrojtjen e shëndetit publik dhe mjedisit në harmoni të plotë me Ligjin Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe Ligjin nr. 06/l-088 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/l-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, Rregullores Nr. 10/2019 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit, Rregullores Nr.10/2019 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit në Kosovë.
- Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKSHPK)** është Institucioni më i lartë shëndetësor, profesional dhe shkencor i Kosovës, që organizon, zhvillon, mbikëqyrë dhe zbaton politikat e shëndetësisë publike në Kosovë. IKSHPK planifikon, programon dhe vlerëson politikat shëndetësore, përgatit dhe zbaton strategjinë e shëndetit publik (Masat higjieniko – sanitare, masat profilaktiko – kundër epidemike, socialo mjekësore, promovimin e shëndetit, edukimin dhe arsimimin shëndetësor, kontrollin e kualitetit të ujit dhe ushqimit, PZI (programi i zgjeruar i imunizimit), politikën shëndetësore dhe ekonomiken shëndetësore, informimin shëndetësorë) në mbarë territorin e Kosovës. Standardet në fuqi për Kualitetin e Ujit të Pijshëm në Kosovë definojnë në Udhëzimi Administrativ (QRK) nr. 10/2021 për Cilësinë e Ujit të Destinuar për Konsum Njerëzor. Përmes UA Nr. 10/2021 për Cilësinë e Ujit të Destinuar për Konsum Njerëzor definohet qartë roli dhe përgjegjësia e IKSHPK dhe KRU-ve për monitorim të

kualitetit të ujit të pijshëm në përputhje me Nenin 8 dhe 9, Monitorimin operacional dhe Monitorimin e përputhshmërisë, përfshirë parametrat për testim, shpeshtësinë dhe vendin e mostrimit.

Palët me vullnet të plotë merren vesh si në vijim:

## **Neni 1**

### **Qëllimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit**

Qëllimi i kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit është të definoj përgjegjësitë e palëve dhe të sigurojë një mekanizëm bashkëpunimi dhe komunikimi të rregullt midis IKSHKP-së & Qendrave Regjionale të Shëndetit Publik (QRSH) në njërën anë dhe ARRU-së në anën tjetër. Kjo marrëveshje midis palëve do të sigurojë një kornizë për bashkëpunim në lidhje me ndarjen (shkëmbimin) e të dhënave të kualitetit të ujit të pijshëm që realizohen nga IKSHKP & QRSH për sa i përket monitorimit të përputhshmërisë dhe të monitorimit operacional të cilësisë së ujit, në rast se KRU-të kanë kontraktuar IKSHKP apo QRSH për kryerjen e monitorimit operacional, në mungesë të laboratoreve vetanake. Bazuar në të dhënat për kualitetin e ujit të pijshëm dhe nivelit të përmbushjes së këtij kriteri, ARRU sigurohet nëse KRU-të kanë përmbushur njërin prej standardeve kryesore që është specifikuar në Nenin 10 (Cilësia e Ujit të Pijshëm) të Rregullores Nr. 10/2019 për Standardet e Minimale të Shërbimit të Ujit.

## **Neni 2**

### **Fushëveprimi i kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit**

Kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit është e kufizuar vetëm në shkëmbimin e të dhënave për kualitetin e ujit që furnizohet nga ofruesit e shërbimeve të ujit të pijshëm përmes sistemeve të ujësjellësit të cilat menaxhohen nga ofruesit e shërbimeve , e të cilët janë të licencuar nga ARRU në përputhje me mandatin ligjor të saj .

## **Neni 3**

### **Përgjegjësitë e palëve ndaj Marrëveshjes së Bashkëpunimit**

#### **a) Shkëmbimi i të dhënave dhe informatava**

IKSHKP (përfshirë edhe QRSH), pajtohen të përcjellin të dhënat në ARRU në periudha të caktuara kohore dhe të dakordohen për çështje të përmbushjes së gjitha dispozitave dhe kërkesave të UA Nr. 10/2021 dhe të Planit të Monitorimit të Kualitetit të Ujit të Pijshëm (Monitorimin e përputhshmërisë) me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të kualitetit të ujit të pijshëm që ofrohet nga ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit.

#### **b) Shpeshtësia e shkëmbimit të dhënave të kualitetit të ujit**

Përmes kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit dhe duke u bazuar në konsultimet paraprake, palët zotohen që të dhënat për kualitetin e ujit të ndahen me sa vijon:

- o QRSH-të do të ndajnë me ARRU në baza mujore të gjitha të dhënat e kualitetit të ujit për muajin paraprak deri në ditën e 10-të të secilit muaj pasues. Të dhënat dërgohen në formë elektronike, përfshirë edhe shkallën e përputhshmërisë së kualitetit të ujit, mendimin profesional nga QRSH-të që uji i ofruar nga ofruesit e shërbimeve të ujit është i pijshëm

- dhe informata të tjera relevante për çfarëdo incidenti signifikant lidhur me mos-përbushjen e standardeve që janë identifikuar.
- IKSHPK do të ndajë me ARRU-në të dhënat vjetore të kualitetit të ujit të përmbledhura për të gjitha KRU-të jo më vonë se fundi i muajit Shkurt të vitit pasues.
- c) **Takimet për shqyrtimin e përbushjes së standardeve të kualitetit të ujit të pijshëm nga ofruesve të shërbimeve të ujit dhe të ujerave të ndotura**  
Të dy palët pajtohen të organizojnë takime të rregullta, së paku njëherë në vit për të shqyrtuar rezultatet e analizave dhe nivelin e përbushjes së kualitetit të ujit nga ofruesit e shërbimeve të ujit.
- d) **Në raste kur shfaqen probleme me kualitet të ujit të pijshëm**
- Në raste kur shfaqen probleme me kualitet të ujit të pijshëm dhe me qëllim të ndërmarrjes së veprimeve të përbashkëta të koordinuara institucionale, palët dakordohen që të organizojnë takime të jashtëzakonshme për të gjetur zgjidhjen sa më të shpejtë dhe sa më adekuate për problemet e shfaqura.
  - Hetimi dhe identifikimin e menjëhershëm të shkaktarëve të problemeve me kualitet të ujit të pijshëm – në rastet kur shfaqen probleme me kualitetin e ujit të pijshëm dhe ka mos-përputhje me standardet relevante që është konstatuar përmes monitorimit (operacional apo të përshtatshmërisë), apo përmes ndonjë burimi tjetër të besueshëm të informatave,
  - Me qëllim të mbrojtjes së shëndetit publik IKSHPK në bashkëpunim me KRU dhe (në zonën e së cilës paraqitet problemi), ARRU dhe palët tjera të interesit brenda zonës së shërbimit dakordohen, konform kornizës ligjore, të njoftojnë publikun për problemin e paraqitur dhe për mos përdorim të ujit për pije, përderisa të jetë sanuar problemi.
  - Me qëllim dokumentimin e bisedave, veprimeve të dakorduara dhe vendimeve të ndërmarra, në takimet e tilla njëra nga palët autorizohet të mbajë procesverbalin e takimit. Minutat e përgatitura nga takimi do të ndahet me të gjitha palët pjesëmarrëse në takim brenda 10 ditë pune nga data e mbajtjes së takimit.
  - Nëse ndonjëra nga palët organizon takime bilaterale me ofruesin e shërbimeve të ujit dhe ujerave të ndotur në zonën e së cilës është paraqitur problemi, pala tjetër do të mbahet e informuar rreth temave të takimit dhe vendimeve të marra përmes kopjimit në korrespondencë dhe ndarjes së minutave të takimit.

#### **Neni 4**

#### **Vlefshmëria e kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit**

Kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit do të jetë në fuqi duke fillu nga viti 2022 dhe vazhdon për vitet e ardhshme. Kjo marrëveshje mund të ri-negocihet apo modifikohet konform amandamentimit të kornizës ligjore. Asnjëra palë nuk mund të ndërmerr ndonjë veprim të një-anshëm për anulim të kësaj marrëveshje apo veprim që dëmton palën tjetër.

## PNeni 5

### Zgjidhje e mosmarrëveshjeve

Palët bien në dakord që çdo mosmarrëveshje që paraqitet nga ose gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshje do të zgjidhet me mirëkuptimin midis palëve.

## Neni 6

### Hyrja në fuqi

Marrëveshje e Bashkëpunimit hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga palët.

## Neni 7

### Dispozita përfundimtare


Kjo marrëveshje është e hartuar në katër ekzemplar identik ku nga dy i marrin palët të tjerat mbesin për nevojat e organit kompetent.

## PALËT NË MARRËVESHJE

Autoriteti Rregullator  
për Shërbimet e Ujit

Hajrije Morina

Drejtoreshë ARRU



Emri dhe mbiemri, nënshkrimi



Instituti Kombëtar për  
Shëndetin Publik në Kosovë

Prof Dr.Naser Ramadani

Drejtor ekzekutiv-IKSHPK



Emri dhe mbiemri, nënshkrimi

